



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

93/5

Tiranë, më 21.12.2017

RELACION

Mbi lenien ne fuqi te vendimit nr. 190 date 30.8.2018 ne lidhje me tarifen e perdorimit te rrjetit te shperndarjes dhe çmimet me pakice per konsumatorët fundore te furnizuar nga furnizuesi i shërbimit universal.

Bazuar ne nenin 19 te Ligjit 43/2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” ERE eshte institucioni pergjegjies per miratimin e tarifave per veprimtarinte e licensuara per te cilat eshte vendosur detyrimi i shërbimit publik. Gjithashtu neni 85 Ligjit 43/2015 percakton se ERE miraton çmime te rregulluara vetem për per kategori të caktuara te klienteve qe furnizohen sipas shërbimit te furnizimit universal dhe keto çmime të miratuara rishikohen mbi baza vjetore.

Keto detyrime jane parashikuar dhe ne; “Metodologjine e llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike” dhe “Metodologjine e përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal” te miratuara me vendimet e Bordit te ERE-s Nr 180 date 10.11.2017 dhe Nr.189 date 23.11.2018.

Bazuar ne Nenin 21 te Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s miratuar me Vendimin Nr.96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE-s, i licensuari ne sektorin e energjise dhe te gazit duhet te paraqese ne ERE jo me vone se data 1 shtator e vitit aktual nje kerkese me shkrim te shoqeruar me te gjithe informacionin e kerkuar sipas metodologjive lidhur me përcaktimin e tarifave dhe çmimeve te shërbimit te energjise per vitin pasardhes.

Verejme se deri me sot shoqerite OSSHsh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. nuk kane paraqitur prane ERE-s aplikime ne perputhje me metodologjite perkatese. Ne keto kushte, bazuar ne nenin 20 te ligjit 43/2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, ERE ka te drejten te miratoje tarifa te perkoheshme ne rastet kur opertaoret e transmetimi ose shperndarjes krijojne vonesa ne ndryshimin e tarifave. Ne rast se, tarifat e miratuara rezultojne te ndryshme nga ato te perkoheshme ERE vendos masa te pershtatshme kompensuese.

Vendimi i ERE-s Nr. 190, Datë 30.08.2018 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “OSHEE” sh.a. për tarifatat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2018” ka miratuar e tarifatat e shërbimit të shpërndarjes dhe çmimet e furnizimit me pakicë si vijon:

Tarifatat dhe çmimet e miratuara nga ERE për vitin 2018

AKTIVITETI I TRANSMETIMIT TE ENERJISE ELEKTRIKE	NR. I VENDIMIT	TARIFAT E MIRATUARA
Tarifa e shërbimit të transmetimit	Nr. 210, Datë 28.12.2017	0.75 Lekë/kWh

AKTIVITETI I SHPERNDARJES SE ENERJISE ELEKTRIKE	NR. I VENDIMIT	TARIFAT E MIRATUARA
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV	Nr. 211, Datë 28.12.2017	1.5 Lekë/Kwh
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 20 kV	Nr. 211, Datë 28.12.2017	3.9 Lekë/Kwh
Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes	Nr. 211, Datë 28.12.2017	4.79 Lekë/Kwh

ÇMIMET E SHITJES ME PAKICË TË ENERJISË ELEKTRIKE PËR KLIEN TËT FUNDOR QE FURNIZOHEN NGA SHERBIMI UNIVERSAL	NR. I VENDIMIT	ÇMIMET E MIRATUARA
Çmimi I shitjes për Konsumatorët e lidhur në TM dhe me matës në TU	Nr. 211, Datë 28.12.2017	12.4 Lekë/Kwh Në Pk 14.3 Lekë/Kwh
Çmimet e shitjes me pakicë për klientët fundor	Nr. 211, Datë 28.12.2017	*Çmimet paraqiten në tabelën më poshtë
Niveli I tensionit	Çmimi (Leke/kWh)	Çmimi pik (Leke/kWh)
Furra buke dhe prodhim mielli në 10/6 kV	7.1	8.17
Klientë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Familjarë	9.5	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (ndriçim shkalle, pompe, ashensor)	9.5	
Tarifë fikse e shërbimit për leximin "zero" (Leke/Muaj)		200
*Çmimi I energjisë reaktive është sa 15% e çmimit të energjisë aktive		
*Orari pak gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar në pik është :		
Për periudhën 1 Nëntor - 31 Mars nga ora 18:00 deri në 22:00		
Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri në 23:00		

ÇMIMET E SHITJES ME PAKICË TË ENERJISË ELEKTRIKE PËR KLIEN TËT FUNDOR QE FURNIZOHEN NGA SHERBIMI UNIVERSAL	NR. I VENDIMIT	ÇMIMET E MIRATUARA
Çmimi I shitjes për Klientët në 20 kV *	Nr. 211, Datë 28.12.2017	11 Lekë/Kwh Në Pk 12.65 Lekë/Kwh
Çmimi I shitjes për Klientët në 10/6 kV *	Nr. 211, Datë 28.12.2017	11 Lekë/Kwh Në Pk 12.65 Lekë/Kwh

* Miratim I përkohshëm për klientët që nuk arrijnë të sigurojnë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit në përputhje me VKM nr. 449, datë 15.06.2016, furnizimi si mundësi e fundit i këtyre klientëve kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit me çmimet si më lart

Sa me sipër, me qëllim që shoqëritë OSSH sh.a. dhe FSHUsh.a. të operojnë në mënyrë normale në periudhën rregullatore në vijim, është e domosdoshme që ato të faturojnë me çmime të miratuara nga ERE për vitin 2019.

Në vijim MIE me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 798/1, datë 19.12.2018, ka përcjelle në ERE problematikat e ndarjes së shoqërisë OSHEE sh.a. ku ndër të cilat me kryesoret që kanë lidhje me përcaktimin e tarifave janë:

Adresa: Bulevardi “Bajram Curri, Rr.Viktor Eftimiu 1023 , Tiranë; Tel +355 42 69 590; www.ere.gov.al; E-mail erealb@ere.gov.al .

- Ne zbatim te procesit te nisur te ndarjes se shoqerise eshte e nevojshme te vijohet me ndryshime nenligjore duke iu referuar nje modeli tregu i cili do te ishte optimal jo vetem per OSHEE sh.a. por edhe per operatoret e tjere te energjise.
- Nevojitet te percaktohet operatori i energjive te rinovueshme jashte OSHEE sh.a.
- T'i jepet zgjidhje problematikes se akomodimit ne treg te sasise se energjise elektrike nga burimet e rinovueshme te energjise (RES) qe rezulton pertej nevojave per mbulimin e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes te Operatorit te Sistemit te Shperndarjes.
- Ne vijim te etapave te mesiperme, nevojitet percaktimi i buxheteve per dy shoqerite: OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. gje qe do te mundesoje vleresimin e te ardhurave te nevojshme per aktivitetet e rregulluara.

Ne perfundim, shoqeria duke reflektuar obligimet e mesiperme do te mundesoje dhe paraqese ne ERE aplikimet per tarifa e çmime te shitjes se energjise per cdo operator ne menyre qe keto tarifa e çmime te mos mbarin subvencione ndermjet aktiviteve.

Se fundmi vendimi i Bordit te ERE-s Nr. 264, Datë 20.12.2018 "Mbi vendosjen e periudhës tranzitore për bërjen efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe te detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike," ,pas kekrkeses se OSHEE sha dhe Shkreses se MIE te protokolluar ne ERE me nr. 798/1, date 19.12.2018, (e cila ka percjelle ne ERE per dijeni orientim ne kuader te ndarjes se shoqerise OSHEE sh.a.), ka reflektuar shqetesimet e mesiperme te Shoqerise.

Ne vijim OSHEE sh.a. me shkresen me nr. 23678, Prot. date 20.12.2018 ka paraqitur prane ERE-s kerkesen e saj per mosndryshim të tarifave të Shërbimit të Shpërndarjes dhe Çmimeve të Shitjes së Energjisë Elektrike për vitin 2019. Kjo kerkese argumentohet me rezultatet paraprake pozitive te vitit aktual 2018.

Propozimi per lenien ne fuqi te tarifave dhe çmimeve aktuale te viti 2018 edhe per periudhen e ardhshme rregullatore 2019 mbeshtetet ne vleresimin se shoqerite do te mund te ushtrojne aktivitetet e shperndarjes dhe shitjes me pakice te energjise elektrike ne kushte normale operimi, nisur nga vleresimi i situates ekonomiko financiare sipas raportimeve te bera pergjate vitit 2018 si dhe shkreses se sipercituar.

Ne vijim paraqesim nje permbledhje te te ardhurave te pritshme te kerkuara per periudhen aktuale krahas atyre te kerkuara nga shoqeria ne aplikimin e dates 14.12.2017 (nr. 26933 Prot) dhe analizes se kryer nga ana jone ne relacionin mbi te cilin u mbeshtet marrja e Vendimit Nr. 190 date 30.08.2018:

Zeri	2018 Aplikim i OSHEE (14.12.2017)	2018 ERE Analize (Vendimi Nr. 190)	2018 Realizimi i pritshem (OSHEE)
Kosto personeli	6,419	6,368	6,025
Post-telekomunikacion	726	726	784
Materiale	408	408	355
Riparime dhe mirembajtje	2,568	2,568	1,625
Marrdhenie me publikun dhe marketing	14	14	14
Konsulenca dhe auditime	119	119	119
Shpenzime ligjore	7	7	84
Shpenzime teknologjie e informacioni	310	310	207
sherbime korporate	-	-	-
Qera	466	466	493
Kosto te tjera	1,169	1,169	1,211
gjjoba	190	-	997
provizionime te ndryshme(+/-) ne total per efekt te kuadrimt	-	-	1,106
Detyrimi per tu shlyer ndaj CEZ Shpernd	-	-	78
Total	12,398	12,157	13,098
kosto tso per humbje	4,357	4,347	4,485
Kosto energjie	25,747	21,805	30,018
Total OPEX	42,502	38,309	47,601
Vlera e aseteteve sipas bilancit te v.2007		16,329	16,329
Vlera e investimeve te kryera ne vitin 2008		1,954	1,954
Asete te financuara npm Granteve		-770	-770
Asete te ndertuara nga KESH dhe te transferuara ne OSSH		1,100	1,100
Vlera e investimeve te kryera per Janar-Maj 2009		3,287	3,287
Vlera e investimeve te kryera per Qershor-Dhjetor 2009		618	618
Vlera e investimeve qe pritet te realizohen ne v.2010		4,681	4,681
Vlera e investimeve te miratuara per vitin 2011		2,395	2,395
vlera e investimeve per vitin 2012		765.883	765.883
vlera e investimeve per vitin 2013		448.465	448.465
vlera e investimeve per vitin 2014		1,208	1,208
vlera e investimeve per vitin 2015		1,626	1,626
vlera e investimeve per vitin 2016		6,996	6,996
vlera e investimeve per vitin 2017		5,029	5,029
vlera e investimeve per vitin 2018		0	6,250
minus : Amortizimi i akumuluar		-1,936	-29,254
Vlera e RAB pa perfshire Kapitalin e Punes	0	43,731	22,663
Kapitali i Punes		1,598	3,967
RAB	0	25,312	26,630
Norma e interesit te borxhit te vjeter	1.190%		1.190%
Norma e interesit te borxhit te ri	2.010%		2.010%
Kthimi I lejuar mbi kapitalin e vet	16.44%		16.44%
Borxh i Vjeter- %	29.73%		29.73%
Borxh i Ri - %	30.27%		30.27%
Raporti I Synuar I Kapitalit te Vet	40.00%		40.00%
Kthim per borxhin e vjeter	0.35%		0.35%
Kthim per borxhin e ri	0.61%		0.61%
Kthimi I lejuar mbi kapitalin e vet	6.58%		6.58%
WACC	7.54%		7.54%
Fitimi	3,408	2,392	2,007
Amortizimi I Vitit	2,958	2,958	2,919
Te ardhura nga Lidhjet e Reja	-376	-376	-662.35
te ardhurat nga Energjia Reaktive	-355.938	-355.938	-356
Axhustim i 2015-2017			
Borxhi i keq	3,170	2,146	1,106
Marveshja CEZ	2,819	-	
Totali i te Ardhurave te Kerkuara	54,125	45,073	52,615
Energji e levruar ne rretin e shperndarjes	4803	4745	4800
Tarifa mesatare e shperndarjes	11.27	9.50	10.96

Adresa: Bulevardi "Bajram Curri, Rr.Viktor Eftimiu 1023 , Tiranë; Tel +355 42 69 590; www.ere.gov.al; E-mail erealb@ere.gov.al .

Sikurse paraqitet ne table, pavaresisht se rezultatet e vitit 2018 jane te pritshme dhe rezultojne me nje çmim mesatar te shitjes se energjise elektrike me te larte nga ai i planifikuar, shoqeria si rezultat i struktures se shitjes pret te realizoje te ardhura ne shumen 54.4 miliard leke per nje sasi te pritshme shitje prej 4800 GWh qe i korrespondon nje cmimi mesatar rreth 11 leke/kWh ndaj 10.7 leke/kWh te miratuar.

Kjo diference ne cmimin mesatar te shitjes me pakice tek kliente fundore qe sherbehen nga Furnizuesi Universal, pritet te sjelle te ardhura te teperta per shoqerine. Keto te ardhura para se gjithash do te sherbejne per rikuperimin e kapitalit negativ te shoqerise por edhe per shlyerjen e detyrimeve ndaj KESH sh.a. dhe OSTsh.a. per periodhat e kaluara sipas marreveshjeve te nenshkruara midis shoqerive.

Tarifa e aktivitetit te shperndarjes eshte e domosdoshme per ushtrimin e aktivitetit nga Shoqërisë OSHE sh.a., aktivitet ky qe ushtrohet konform Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjise Elektrike” si dhe direktivave të Komunitetit të Energjisë, per me teper rregullimi i aksesit në rrjet duhet të jetë i garantuar dhe te ofrohet nga shoqëria me tarifa të rregulluara nga ERE.

Ne zbatim te nenit 20 te ligjit 43/2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” dhe per sa me lart parashtruar, propozojme:

1. Lenien ne fuqi te Vendimit 190 date 22.12.2016 te Bordit te ERE-s
2. Rishikimin e të ardhurave të kërkuara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit te Sherbimit Universal në periodhat pasardhëse për vlerësimin e të ardhurave të kërkuara për vitin 2019.